




**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
*Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority*



**Prishtinë, më 20.06.2024**

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, mbështetur në nenet 11, 13, 17. të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, të Publikuar në Gazetën Zyrtare, datë, 14 Qershor 2022, Udhëzimit Administrativ 02/2023 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve shpallë këtë :

**NJOFTIM I PËRQENDRIMIT**

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 20.05.2024, me Nr. Prot. 311/24-01/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “Vokshi & Lata” Përfaqësues Ligjor Urim Vokshi, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët Lufthansa Technik AG (LHT) dhe LG Electronicf Inc. (LGE) mbi SP-të.

Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në marrëveshjen Joint Venture, e datës 23 Tetor 2018, si dhe është ndryshuar me “ Marrveshjen”, e datës 4 Prill 2019, Lufthansa Technik AG (LHT) dhe LG Electronicf Inc. (LGE) krijuan një sipërmarrje të përbashkët (joint-venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët (SP).

**Lufthansa Technik AG (LHT)**, është një shoqëri globale e regjistruar në Gjermani, me seli në Hamburg, Gjermani me numër të regjistrimit të biznesit HRB 56865; Ajo është (përmes Lufthansa Commercial Holding GmbH) një filiale tërësisht në pronësi të Deutsche Lufthansa AG dhe pjesë e Grupit Lufthansa.

**LG-LHT Aircraft Solutions GmbH**, e regjistruar në Hamburg, Gjermani me numër të biznesit HRB 157217, fokusohet në zhvillimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe shitjen e produkteve dhe shërbimeve për linjat ajrore komerciale, OEM të avionëve komerciale dhe kompani të tjera të përfshira në aviacionin komercial.

**LG Electronics Inc.**, është një kompani globale me seli në Seul, Koreja e Jugut me Nr.Regj. 248705, LGE është një tregtues dhe furnizues mjetesh elektronike, pajisjesh lëvizëse. Ajo është aktive në prodhimin dhe furnizimin e elektronikës, komunikimeve celulare, pajisjeve shtëpiake dhe zgjidhjeve ajrore, si dhe komponentëve të automjeteve.

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1

Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)

Njoftohet, Përfaqësuesi i Autorizuar se nga data 19.06.2024 Autoriteti konsideron se lënda është e kompletuar (e plotë) me ç'rast nga kjo datë, Autoriteti fillon procedurën e vlerësimit të përqendrimit.

Autoriteti, fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, me Adresë Rr. Migjeni kati VI [ish objekti i bankës së Lubjanës] Nr. tel :+381 /0/ 38 200 10982, apo në email adresën: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net), në afatin prej 15 ditëve nga dita e publikimit në webfaqe të AKRK-së.

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1

Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)